

Më
Dana

28 - 09 - 2018

P.nr.286/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me Bashk.Profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] me vendbanim në fsh. [REDACTED] Komuna Shtime, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.808-7/16 të dt. 15.02.2018, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6, lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rrith kërkësës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.03.05.2018 solli:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.808-7/16 të dt. 15.02.2018, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] me vendbanim në - fsh. [REDACTED], Komuna Shtime, i lindur me datë, [REDACTED] në Ferizaj nga i ati [REDACTED] e ema [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal [REDACTED] mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 17.05.2016, rrith orës 05:20, ne Shtime, përkatësisht ne dalje te Shtimes , tek pompa e derivateve “Migroll Petroll”, duke drejtuar automjetin e markës “Audi A4”, me targe te regjistrimit [REDACTED], duke vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 54/1 te LSKRR-se, nga pakujdesia duke mos e pershtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve te rrugës kur hynë ne kthesë nuk mund te përballoj ne mënyre ta sigure humb kontrollin ndaj timonit, kalon ne shiritin e kundërt te lëvizjes e me pas del jashtë rruge dhe godet një kontejner te mbeturinave, me te cilin rast pos dëmeve materiale, lëndime te lehta trupore pëson, [REDACTED] lëndime këto te përshkruara ne ekspertizën mjeko-ligjore te datës 10.01.2018,-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton.

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDACTED] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin: [REDACTED], nga [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.808-7/16 të dt.15.02.2018, ka akuzuar [REDACTED] me vendbanim në fsh.[REDACTED], Komuna Shtime, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënen e urdhërit ndëshkimore kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.08.02.2018, dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit rrugor te datës 26.11.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 463 parag.1 lidhur me par.3.të KPPK-së të dëmtuarin: [REDACTED], me vendbanim në [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e udhëzon në kontest civil.


Konformë nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro, si dhe paushalin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.286/18 i dt.03.05.2018

Bashk.Profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjyques të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimore bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimini i shqiptuar.